Kronikë

Sarandë/ Tregtonin lëndë piroteknike ilegalisht nis hetimi për dy persona! Sekuestrohen 982 fishekzjarre dhe 250 kuti me kapsolla (EMRAT)

Policia e Sarandës ka goditur një tjetër rast të tregtimit të lëndëve piroteknike pa autorizim

[Sh.com] Redaksia
28 Dhjetor, 12:33 | **Përditesimi: 28 Dhjetor, 12:46**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Policia e Sarandës ka goditur një tjetër rast të tregtimit të lëndëve piroteknike pa autorizim. Dy pronarë dyqanesh, Leonidas Marini, 26-vjeç dhe Mentor Halo, 55-vjeç do të hetohen në gjendje të lirë.

Gjatë kontrolleve të kryera në subjektet e tyre tregtare blutë sekuestruan 982 fishekzjarre dhe 250 kuti me kapsolla.

> *"Në vijim të zbatimit të planit të masave për parandalimin dhe goditjen e tregtimit të kundërligjshëm të lëndëve piroteknike, në prag të festave të fundvitit, shërbimet e Komisariatit të Policisë Sarandë kanë vijuar kontrollet në subjekte tregtare.*

[Sh.com] LEXO EDHE:
Skandal/ Vlora 3 ditë pa ujë, qytetarët në radhë për të mbushur bidonët në burim! Prishin mbrëmjen gala të Bashkisë, futen me forcë në teatrin e qytetit (VIDEO)

Si rezultat i këtyre kontrolleve, gjatë kontrollit të ushtruar në dy subjekte tregtare në qytetin e Sarandës, u konstatuan 982 fishekzjarre dhe 250 kuti me kapsolla, të cilat mbaheshin për tregtim në kundërshtim me ligjin.

Lëndët piroteknike u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, ndërsa materialet procedurale u referuan në Prokurori dhe nisi procedimi penal në ngarkim të shtetasve L. M., 26 vjeç dhe M. H., 55 vjeç, banues në Sarandë", njoftoi sot policia

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Mentor Halo | Leonidas Marini | kapsolla | fishekzjarre | lende piroteknike | Vlore | sarande

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[Sh.com]
Sondazhi i ditës:
Si ka qenë 2025-a për ju?
27 Dhjetor, 14:09
Vit i mirë | Vit i keq | Njësoj

Lajme të tjera

Mumushe Ibrahimi, një jetë mes pasionit me punët artizanale! 85-vjeçarja vijon ende të qepë jorganë e thur qilima në Sarandë
Limos Didani
28 Dhjetor, 18:47

VIDEOLAJM/ Qytetarët vlonjatë sfidojnë të ftohtin, e mbyllin vitin duke u larë në det
28 Dhjetor, 15:12

Fishekzjarret jashtë kontrollit, 15 vjeçari nga Durrësi përfundon në spital me dëmtime në fytyrë
28 Dhjetor, 13:08

Vlora prej 3 ditësh pa ujë të pijshëm, qytetarët mbushin në burime! Spitali furnizohet me autobotët e zjarrfikësve (VIDEO)
Armand Xhelili
28 Dhjetor, 09:58

Nën akuzë për shpërdorim detyre, Prokuroria Fier dërgon në gjyq ish-drejtorin dhe specialistët e Agjencisë Rajonale Mjedisore
28 Dhjetor, 09:43

Ekipet mjekësore në gatishmëri për festat e fundvitit, vijojnë punimet për qendrën rajonale të Urgjencës në Vlorë
28 Dhjetor, 08:24

Vlora pa ujë prej mbi 48 orësh, defekt i rëndë në linjën kryesore! Momenti kur shpërthen tubacioni
Armand Xhelili
27 Dhjetor, 15:57

Sekuestrohen 179 fishekzjarre në një market në Vlorë, vihet nën hetim shitësja (VIDEO)
27 Dhjetor, 13:11

Sarandë/ Lejuan ndërtimet pa leje në zonë të mbrojtur në Butrint, prokuroria dërgon për gjykim 3 inspektorët dhe kreun e IVMT-së bashkë me ndërtuesin (EMRAT)
27 Dhjetor, 09:21

Zbatica zbulon rërën në plazhin e vjetër në Vlorë dhe Zvërnec, pamje e rrallë e bregdetit (VIDEO)
26 Dhjetor, 15:10

Vlorë/ U godit me top në kraharor gjatë lojës së futbollit, ndërron jetë 42-vjeçari
26 Dhjetor, 10:09

Vodhën naftë nga makinat e punës, pezullohen 3 punonjës të Bashkisë Vlorë
25 Dhjetor, 12:30

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje